

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Komisionin e Ligjeve/ PD kërkon seancë dëgjimore, Manja e mir aton
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/15/pd-kerkese-per-zhvillimin-e-nje-seance-degjimore-per-s-tatusin-e-gjyqtareve-dhe-prokuroreve-ulsi-manja-e-miraton-te-komisioni-i-ligjeve/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:37:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	15 shtator 2026, 10:32:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 15 shtator 2026, 10:31:00 UTC → 15 shtator 2026, 10:33:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fd117087de42f616d238c14e51bad09f25e4fbcc4b349dce84d394952d2a7576
TEKSTI	9bedc8a5051becc5dc9613a970bd16678d546380695eac5b4790aaa2adb7c86a
PAMJA	0101dbd7f1fa1465e7a1483c1465d3d1b3819f87e373ba064404dddf94578040

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	beb448b38cdda21dbd06a56f34e3e8d84d3c015342f38a63ee49a712a215e322
E MËPARSHMJA	665e737a220cc8ba89dc254c3eb546f1c583311008434ed02078d6052e4cc38e
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/beb448b38cdda21dbd06a56f34e3e8d84d3c015342f38a63ee49a712a215e322>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KRYESORE POLITIKË TË FUNDIT

Statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Komisionin e Ligjeve/ PD kërkon seancë dëgjimore, Manja e miraton

15/09/2026 12:32



Partia Demokratike ka kërkuar ditën e sotme zhvillimin e një seance dëgjimore publike mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar".

PD kërkoj të thirren në seancë dëgjimore për të dhënë mendimin e tyre institucionet dhe shoqatat që kanë interes në këtë çështje, si Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Unionin e Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqatën Kombëtare të Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqatën e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e Gjykatës së Lartë.

Këtë kërkesë e ka propozuar në Komisionin për Çështjet Logjore edhe deputeti Oerd Bylykbashi.

Pas kërkesës së Bylykbashit, Ulsi Manja ka miratuar kërkesën për këtë seancë dëgjimore, duke spostuar orarin nga ora 15:00 në orën 13:00.

Oerd Bylykbashi: Fakti që ne jemi komision përgjegjës, duhet të presim edhe qëndrimet e komisioneve të tjera. Kjo tregon çfarë lloj procesi legjislativ kemi këtu në Parlament. Është një nga ato ligje që kërkuar punë prej muajsh. Një nga vërejtjet kryesore të GJK ishte që projektligjit i mungonte konsultimi me grupet e interesit, sërish rezultojnë njëjtë gjë. Ata priten që Parlamenti brenda afatit të kishte marrë një vendim dhe të miratonte ndryshimet ligjore të kërkuara. KLGJ dhe KLP morën qëndrime dhe vendime prej një krize kushtetuese, sepse Parlamenti nuk respektoi vendimet e GJK.

1/3 e deputetëve të komisionit ka bërë kërkesë për seancë dëgjimore me KLGJ, KLP, Unionin e Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqatën Kombëtare të Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqatën e Prokurorëve të Republikës, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e Gjykatës së Lartë. Bëmë kërkesë për seancë brenda orës 15:00, në mënyrë që Parlamenti dhe ky komision, kur të marrin vendim, të ketë dëgjuar mendimin e tyre.

Ulsi Manja: Kemi në thelb një kërkesë për procedurë. Ne i kemi marrë opinionet me shkrim edhe të KLP dhe KLGJ, edhe të shoqatave. Por kjo nuk do të thotë se opinionet me shkrim zëvendësojnë seancat dëgjimore. Siç e ka Kuvendi i Shqipërisë këtë projektligj për konsultim publik, është në faqen e Kuvendit. Ai i është nënshtruar konsultimit. Për sa i përket kërkesës së Bylykbashit, rregullorja e re nuk ka lënë hapësirë për diskutim nëse duhet bërë seancë apo jo.

Kështu që, ndërkohë që ne besoj shprehemi për t'u realizuar seanca sot, unë u propozoj kolegëve që seanca dëgjimore me institucionet e kërkuara të zhvillohet sot, ndërkohë që ne do të vazhdojmë me prezantimin në parim të projektligjit dhe pas prezantimit, që nga ky moment të njoftojmë për në orën 13:00 listën e institucioneve që do të vijnë këtu për t'u dëgjuar. Miratohet kërkesa për seancë dëgjimore, ora spostohet në orën 13:00.

I Kryesore



Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

11:06

Dosja "Revanshi" / GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë

09:32

Cënuan perimetrit e sigurisë në shkolla gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë

10:39

Vuçiç zbulon datën e dorëheqjes, presidenti i Serbisë: Fushatën e vazhdoj si qytetar i thjeshtë

11:34

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

09:50

I Më të lexuarat

Mbyllet gjyqi ndaj Thaçit në Hagë! Procesi për pengim të drejtësisë, mbrojtja kundërshtoi transkriptet e prokurorisë dhe kërkoj pajfjësi

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshitin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uells dhe Irlanda e Veriut kërkojnë referendum: E ardhmja jonë është në BE

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënime kryesore

"China Zorrilla", anija më e madhe elektrike në botë mbërrin në Uruguai, nis udhëtimet në tetor

"O kukull, projektligji për kinemanë do deformojë filmin duke futur video-lojëra", Mevlan Shanaj përballet live në "Ftesë në 5" me drejtorin e QK, Jorgji: Po flitet keq për njerëz që punojnë

"FBI kishte mijëra përgjime për Al Caponen, por s'kishte prova", Filip Çakuli: Veliajn e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

Nga një 'like' në Instagram te propaganda

I Kryesore »



Pamjet e reja nga Shtëpia e Bardhë, Trump prezanton portin luksoz të helikopterit: Po rikthej bukurinë dhe shkëlqimin në nivele të papara

15/09 12:36



Veliaj u la në burg, reagon avokati Ndreca: Gjykata e Lartë la në fuqi një vendim marrje të shfuqizuar nga Kushtetuesja, cënohet shteti i së drejtës

15/09 12:31



Marrja e kontrollit të Ngushticës Bab el-Mandab nga Huthit, OKB njofton mbledhje urgjente të Këshillit të Sigurisë

15/09 12:26



Rrëzohet kërkesa e Ilir Metës, GJKKO lë në burg ish-presidentin

15/09 12:17



Kryeministri Rama në Napoli, vizitë në Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit "L'Orientale"

15/09 11:57



I kërkuar nga SPAK si pjesë e grupit ndërkombëtar të trafikut të drogës, arrestohet në Belgjikë "Cinja" i Shijakut

15/09 11:52

I Politikë »



Përplasja për tenderat në komisionin "Xhafaj"/ Deputeti Kaso: Kalohen me 99.9% të fondit, ofertuesit "vetëdigjen". Drejtoresha Kashta: Gjithçka transparente

15/09 12:25



Kryeministri Rama në Napoli, vizitë në Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit "L'Orientale"

15/09 11:57



Debate në komisionin "Xhafaj"/ Kryetari: Rastet të trajtohen, bëra 7 ankesa për zhurmën. Agjencia për Bashkëqeverisje: Kemi institucione problematike

15/09 11:05



"Nafta mbi 229 lekë/litër", denoncimi i PD-së: Qeveria nuk po ndërhyr për uljen e çmimit, të eliminohet taksa e qarkullimit

15/09 10:47



Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson dot parlamentin dhe as nuk e urdhëron dot legjislativin

14/09 23:10



Presidenti Begaj vizitë zyrtare në Abu Dhabi: Shqipëria synon më shumë investime nga Emiratet e Bashkuara Arabe

14/09 21:21

Na ndiqni:

Top Channel

@topchannelalbania

@tchbreakingnews

Top Channel


I Video »



Top Channel/ Statusi i



Top News – 'Pasqyra' mbërrin



Top Channel/ Përplasja për

serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë

Pikë referimi për shqiptarët në Itali/ Inaugurimi i Konsullatës së Nderit të Shqipërisë, kryeministri Rama në Napoli për ceremoninë

gjyqtareve të Ligjet, PD kerkon seancë dëgjimore, Manja e miraton



Top Channel/ Erion Veliaj mbetet në burg, Gjykata e Lartë rrëzoi kërkesën e avokatëve të tij

ne Kuvend. Platforma me ligj te veçantë për ankesat e qytetarëve



Top News – Armatimi ka dalë në hapësirë / SHBA pranon se ka armë në orbitën e tokës-Gati për sulm!

tenderat të "Xhataj", Kaso: Kalohen me 99.9%, ofertuesit "vetëdijjen"



Top News- Vetë me pushime, 'punuan' asistentët/ Deputetët e Kosovës, 50 mijë euro për ndihmësat

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Bileta
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.